

LIGJ
Nr. 50/2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 11, pika 3, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) kompensim për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm;”.

Neni 2

Në nenin 12, pika 5, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. “Shtesa për pozicion” është elementi bazë i pagës mujore të nëpunësve civilë, nëpërmjet së cilës caktohet vlera e çdo vendi pune në shërbimin civil, pa u diktuar nga ndryshimet e pagës që shkaktohen nga rrethanat e posaçme ose individuale të vetë nëpunësit civil si vjetërsia apo shtesa për kushte pune. Për qëllimet e caktimit të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, “shtesa për pozicion” është i njëjti element i pagës si edhe elementi “paga bazë e kategorisë”, sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, apo me çdo lloj emërtimi tjetër që cakton elementin bazë të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” ose “paga bazë e kategorisë” sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.”.

2. Në shkronjën “d” togfjalëshi “60 për qind të pagës bruto fillestare” zëvendësohet me togfjalëshin “80 për qind të pagës bruto fillestare”.

Neni 3

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1
Paga e magjistratëve në skemë delegimi

1. Magjistrati në skemë delegimi përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.

2. Magjistrati në skemë delegimi, që përmbush kriteret për t'u ngritur në detyrë në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, si dhe përmbush kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, sipas pikës 3 të nenit 47 të këtij ligji, gjatë periudhës së delegimit në këto institucione përfiton shtesën për vështirësi pune sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji. Në rastet kur magjistrati delegohet për çështje të veçanta, ai përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo më shumë se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji.

Këshillat, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse të financave, përcaktojnë rregulla të detajuara për masën e shtesës së reduktuar për vështirësi pune dhe mënyrën e llogaritjes së saj duke u bazuar në llojin, natyrën, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e çështjeve për të cilat delegohen.

Neni 4

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15

Kompensimi i magjistratëve

1. Magjistrati në skemën e delegimit i caktuar në një gjykatë ose prokurori, si dhe magjistratët e tjerë, kur transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht për jo më shumë se 22 ditë pune, përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ose prokurorisë ku delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht. Shpenzimet e transportit llogariten në bazë të distancës më të shkurtër që rezulton ndërmjet gjykatës ose prokurorisë ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose me vendbanimin e tij të përhershëm.

2. Magjistrati në skemën e delegimit, magjistrati i transferuar përkohësisht ose magjistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magjistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht.

3. Magjistrati nuk përfiton kompensimet sipas këtij neni në rastet kur gjykata ose prokuroria ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht ndodhet në të njëjtin territor me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose në territorin e vendbanimit të tij të përhershëm.

4. Rregulla të detajuara për mënyrën e caktimit të kompensimit dhe masës së tij sipas këtij neni, përcaktohen nga Këshillat pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat."

Neni 5

Në nenin 22, pika 1, shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) vlerësohet i pamjaftueshëm ose jepet masa disiplinore e uljes së përkohshme të pagës, sipas parashikimeve të këtij ligji;"

Neni 6

Në nenin 27 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 shkronja “c” shfuqizohet.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.

1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më qel nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0.6 për qind në muaj.”.

Neni 7

Në nenin 28 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuara me ligj.”.

2. Në shkronjën “ç” pas togfjalëshit “me kohë të plotë” shtohet togfjalëshi “pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni.”.

3. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.”.

4. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.”.

Neni 8

Në nenin 32 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

4. Në çdo rast Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë.”

5. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.”.

Neni 9

Në nenin 34 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Verifikimi i pasurisë dhe figurës dhe renditja e kandidatëve magjistratë të diplomuar”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo vit, jo më vonë se në fund të muajit janar, Shkolla e Magjistraturës u dërgon Këshillave listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Çdo vit, deri në fund të muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti.”.

Neni 10

Në nenin 35 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Në pikën 4 shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:

“a) emërojnë magistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, ose refuzojnë të emërojnë magistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, por që nuk përmbush kriteret e emërimit;

b) lejojnë kandidatin që përmbush kriteret e emërimit për t’u emëruar në vitin pasardhës, pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 11

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Riemërimi magistrat i ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve

1. Ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët mund të kandidojnë për t’u riemëruar si magistratë jo më vonë se dy javë pas shpalljes së vendeve të lira, sipas pikës 1 të nenit 39 të këtij ligji.

2. Këshillat shqyrtojnë kërkesat për t’u riemëruar në rast se numri i vendeve të lira është më i madh se numri i të diplomuarve që përmbushin kriteret e emërimit sipas nenit 35 të këtij ligji.

3. Këshillat mund të riemërojnë magistratë, brenda numrit të vendeve të lira, kandidatët që:

- a) përmbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “P” të nenit 28 të këtij ligji;
- b) kanë ushtruar funksionin e magistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit;
- c) nuk kanë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit, përpara kërkesës për riemërim si magistrat.

ç) kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës, sipas rregullave të caktuara në nenin 32 të këtij ligji.

4. Këshillat vendosin të refuzojnë riemërimin kur kandidati nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve që mund të riemërohen si magistratë në rastet kur numri i vendeve të lira është më i vogël se numri i kandidatëve që kanë kandiduar për t’u riemëruar dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.”.

Neni 12

Në nenin 39 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Jo më vonë se dy javë nga shpallja e vendeve të lira, të emëruarit i bëjnë me dije Këshillit, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata ose prokurori në të cilat kërkojnë të caktohen.”.

2. Në pikën 3 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të emëruarit, sipas pikës 1 të këtij neni, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni.”

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pas caktimit në pozicion të të emëruarve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, Këshillat shpallin vendet e lira për caktimin në pozicion të magistratëve të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji.”

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Caktimi në pozicion i të riemëruarve sipas nenit 36 të këtij ligji bazohet:

a) së pari, në rezultatet e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji;

b) së dyti, në rastin kur ka barazi në aftësitë profesionale, mbizotëron kriteri i përvojës profesionale, duke iu referuar viteve të përvojës në sistemin gjyqësor ose prokurorisë;

c) së treti, duke përmbushur preferencat në tri gjykata ose prokurori të deklaruar nga të riemëruarit, në respektim të përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, për aq sa gjejnë zbatim.”.

Neni 13

Në nenin 43 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 shkronja “b” shfuqizohet.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.”.

3. Në pikën 7, shkronja “a”, nënparagrafi “i” ndryshohet si më poshtë:

“i) që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, si anëtar i Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar, do të ketë përparësi;”.

4. Në pikën 8, shkronja “a”, hiqet togfjalëshi “sipas pikës 6 të këtij neni”.

5. Në pikën 12 shkronjat “a” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;”.

Neni 14

Në nenin 45 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 fjala “komanduar” zëvendësohet me fjalën “caktuar”.

2. Në pikën 4 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori, për të cilën magjistrati përmbush kërkesat. Në rastet kur caktohet për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të përmbushë kriteret, si dhe të japë pëlqimin sipas nenit 47 të këtij ligji. Delegimi për një çështje të veçantë kryhet kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.”.

3. Në pikën 6 pas togfjalëshit “t’i kërkojë Këshillit cakimin” shtohet togfjalëshi, “Për një çështje ose”.

Neni 15

Në nenin 47, pika 2, shkronja “b”, pas togfjalëshit “ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” shtohet togfjalëshi “duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Neni 16

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.”.

2. Në pikën 14 shkronjat “a” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;”.

Neni 17

Në nenin 53 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas togfjalëshit “brenda sistemit të drejtësisë” shtohet togfjalëshi “ose organizatë ndërkombëtare”.

2. Në pikën 2 pas togfjalëshit “dhe përafrimit të legjislacionit” shtohet togfjalëshi “si dhe organizatat ndërkombëtare.”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“8/1. Magjistrati që komandohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 18

Në nenin 64 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës. Mbarimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit të Prokurorisë së Posaçme deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”.

Neni 19

Pas nenit 170 shtohet neni 170/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 170/1

Caktimi i magjistratëve për çështje të veçanta

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm dhe transferimi i përkohshëm i magjistratëve është i padobishëm për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshillat mund të caktojnë një magjistrat për gjykimin ose hetimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë ose

prokurori të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ka një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh ose prokurorësh në një gjykatë ose prokurori; ose

b) kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.

2. Magjistrati që caktohet për një çështje të veçantë përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji.

3. Këshillat përcaktojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për caktimin e magjistratëve për çështje të veçanta.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë për çështje të veçanta sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.”.

Neni 20

Pas nenit 170/1 shtohet neni 170/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 170/2

Caktimi i përkohshëm në pozicione të lira të përkohshme

1. Kur numri i të emëruarve të sapodiplomuar është më i madh se vendet e lira të shpallura për ata, të emëruarit që nuk janë caktuar në një pozicion të lirë të përhershëm për magjistrat caktohen përkohësisht në një pozicion të lirë të përkohshëm.

2. Këshillat shpallin pozicionet e lira të përkohshme për të emëruarit e sapodiplomuar brenda një jave nga përfundimi i caktimit të të emëruarve në pozicionet e lira të përhershme.

3. Në rastet e caktimit të përkohshëm në një pozicion magjistrati:

a) Këshillat i ofrojnë të emëruarit mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione, sipas radhës së renditjes së tyre në listën e të diplomuarve;

b) i emëruari i caktuar përkohësisht në një pozicion magjistrati duhet të marrë pjesë në procedurën e radhës së lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë të përhershëm.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë përkohësisht në pozicione të lira të përkohshme, sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.”.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.